

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 4

Kodi: 005

MENDIMI KRITIK GJATË LEXIMIT DHE SHKRIMIT

Tipi i programit: Themelor

Hyrje

Programi i trajnimit “Mendimi kritik gjatë leximit dhe shkrimit” është zhvilluar në vitin 2000 nga Qendra për Arsim e Kosovës, me përkrahjen e Shoqatës Ndërkombëtare të Leximit (International Reading Association) me seli në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Programi njihet me shkurtësën MKLSH dhe është shndërruar në programin më ikonik të zhvillimit profesional të mësimeve me metodologji bashkëkohore të mësimit. Me mijëra mësime në mbarë Kosovën kanë përfituar nga ky program trajnimi, duke bërë ndryshimin edhe në klasat e tyre.

Bazuar në analizën e nevojave për zhvillim profesional të mësimeve dhe modaliteteve më të pranueshme për mësime, KEC në vitin 2026 e ka bërë një rishikim të plotë të programit, duke e shkurtuar ca kohëzgjatjen e tij, por pa e prekur bërthamën dhe strukturën e programit. Po ashtu, gjatë rishikimit janë pasqyruar zhvillimet e reja në arsim, e veçanërisht në dinamikën nëpër klasat tona, duke e bërë më të afërt me nevojat aktuale të mësimeve.

Qëllimet e programit dhe rezultatet e pritura

Qëllimet e programit të trajnimit janë:

- Të zhvillojë marrëdhënie të hapura, bashkëpunim afatgjatë dhe kolegjal midis mësimeve nga kultura, mjedise dhe rrethana të ndryshme;
- Të zgjerojë gjykimin për mësime dhe të nxënësve për të gjithë fëmijët dhe t'i bëjë ata të shfaqin idetë e tyre me njerëz të tjerë;
- Të rrisë aftësinë e nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, për reflektim kritik, për marrje përgjegjësie për të nxënësve të tyre, për formim qëndrimesh të pavarura dhe shfaqje respekti për mendimet e të tjerëve;
- Të paraqesë teknika praktike për mësime, duke u bazuar në ide që tingëllojnë të qëndrueshme në pikëpamjen filozofike dhe teorike;
- Ta vendos mësime brenda një strukture të kuptueshme mësime që jep udhëzimet për marrjen e vendimeve;
- Të forcojë kolektivin pedagogjik për të marrë përgjegjësinë për t'u bërë mësues model për zhvillimin e mendimit kritik, të aftë për të reflektuar në të menduarit dhe të nxënësve dhe për të përpunuar teknikat, duke u bazuar në këto reflektime;
- Të shtojë besimin e mësimeve, duke u bazuar në zbatimin e suksesshëm të programit në nivelin dhe lëndën ku japin mësime.

Me përvetësimin e këtij programi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 4

- Të krijojnë klasa që nxisin bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm;
- Të përdorin një strukturë për mësimdhënien që nxit mendimin kritik dhe të nxëniet e pavarur;
- Të përdorin teknika të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë nxënësit në procesin e përvetësimit të njohurive dhe kontrollimit të tyre;
- Të bëhen burim përvoja dhe njohurish për mësimdhënësit e tjerë.

Me zbatimin e këtij programi, nxënësit aftësohen:

- Të mendojnë në mënyrë kritike. Ata përgatiten që të jenë kureshtarë dhe të përdorin strategjitë e kërkimit dhe shqyrtimit të pavarur, të bëjnë pyetje dhe në mënyrë sistematike të kërkojnë përgjigjet e tyre;
- Të marrin përgjegjësinë për të nxëniet e tyre. Nxënësit përgatiten që mos t'i marrin njohuritë e dhëna nga mësimdhënësi në mënyrë pasive, por të përdorin strategjitë vetjake të shqyrtimit përmes procesit të të lexuarit, shkruarit dhe diskutimit. Nxënësit mësohen të bëjnë sistemimin e informacionit dhe të vënë në përdorim shprehitë e studimit të pavarur;
- Të punojnë bashkë me të tjerët. Nxënësit aftësohen për të dëgjuar të tjerët me kujdes dhe respekt, të flasin me mirësjellje dhe të kenë besim te të tjerët, të përdorin strategjitë për identifikimin e problemeve e të kontribuojnë në gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta, duke vepruar si anëtarë të përgjegjshëm të grupit;
- Të bëhen qytetarë që mësojnë gjatë gjithë jetës. Nxënësit përvetësojnë strategjitë e kërkimit, me qëllim që të jenë në gjendje t'i përdorin ato edhe pas përfundimit të shkollimit.

Përmbajtja

Programi i trajnimit në aspekt të përmbajtjes është një gërshetim i shqyrtimeve konceptuale të temave dhe demonstrimeve praktike përmes teknikave e strategjive, pasuar me analizë kritike të zbatimit të atyre teknikave e strategjive. Temat që shtellohen, sipas ditëve, janë dhënë në vijim:

- 1. Strukturë për zhvillimin e mendimit kritik gjatë kurrikulumit.** - Sfidat e mësimdhënies bashkëkohore. Ç'është mendimi kritik? Karakteristikat e metodologjive me nxënësin në qendër (Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit dhe Korniza e Kurrikulës së Kosovës). Mësimdhënia për zhvillimin e të menduarit. Krijimi i një mjedisi për mendimin kritik. Përgjegjësia e nxënësit për mendimin kritik. Të menduarit dhe të nxëniet. Një strukturë për mësimdhënien dhe të nxëniet: Evokimi, Realizimi i kuptimit dhe Reflektimi (ERR). Teknikat: Stuhi mendimesh (Brainstorming), INSERT, Tabela e INSERT-it, , Diskutim në grup, Shqyrtimi kategorizues. Copëzat e përziera dhe Analiza e tipareve semantike. Arsyetimet për qëllimet e fazës së evokimit, realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Mendimi kritik dhe struktura. Fleta organizuese e teknikave. Reflektimi mbi të nxëniet dhe përdorimi i skedave të daljes si instrument i vlerësimit formues.
- 2. Teknika tjera për zhvillimin e të menduarit kritik.** - Teknikat mësimore: Mini-leksion, DRTA, Shqyrtimi i përbashkët, M/P/Th, Ditari dypjesësh, Kubimi, Gjeje titullin, Tabela e koncepteve. Analiza e detajuar pedagogjike, psikologjike dhe procedurale e teknikave të lartpërmendura dhe theksimi i përparësive të zbatimit të tyre në klasa. Rezultatet e të nxëniet dhe klasifikimi i tyre sipas taksonomisë së Blumit. Karakteristikat e rezultateve të të nxëniet dhe përpilimi i tyre.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 4

3. Zhvillimi kognitiv i fëmijës dhe të nxënësve në bashkëpunim. – Zhvillimi kognitiv dhe social i fëmijës. Njohuritë për të menduarit. Të menduarit kritik. Shprehjet e të menduarit kritik dhe Taksonomia e Blumit. Pyetjet dhe vlera e tyre.

Arsyetime për të nxënësve në bashkëpunim. Bashkëpunimi i nxënësve të një klase si një mjedis për të menduarit kritik. Karakteristikat e klasës që bashkëpunon. Përbërësit kryesorë të të nxënësve në bashkëpunim dhe përfundimet e tij.

Teknikat: Leksioni i avancuar, Diagrami i Venit, Kllaster, Ndërthurja I (Xhigsou), Shkrim i lirë, Ruaje fjalën e fundit për mua, Pesëvargëshi, Tabela T.

4. Teknika tjera për zhvillimin e të menduarit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit. – Teknikat: Mësimdhënia e ndërsjellë, Stilolapsat në mes, Di/duatë di/ mësova, Rrjeti i diskutimit, Pyetje drejtuar autorit, RAFT, Analiza e detajuar e teknikave të mësuara dhe shqyrtimi i rasteve për zbatimin e tyre në klasa dhe në lëndë të ndryshme. Planifikimi në mënyrë individuale i një mësimi model për zbatim në klasë dhe diskutimi i tij.

5. Planifikimi i mësimit dhe vlerësimi. – Klasifikimi i mjeshtërive themelore të mësimdhënies. Planifikimi i mësimit. Përzgjedhja e veprimtarive të të nxënësve. Plani i mësimit për mendimin kritik. Diskutimi i modelit të planit mësimor: Motivimi, Objektivat, Kërkesat fillestare, Vlerësimi, Burimet dhe mbikëqyrja e kohës, Grupimi, Evokimi, Realizimi i kuptimit, Reflektimi, Mbyllja dhe veprimtaritë e zgjedhura për zgjerim të njohurive. Vlerësimi. Qëllimet e vlerësimit. Tipet e vlerësimit. Përmirësimi i praktikave të vlerësimit. Teknikat: Të lexuarit në dyshe, Turi i galerisë.

Grupi i synuar

Nga ky program mund të përfitojnë: mësimdhënësit e të gjitha niveleve të shkollimit dhe të lëndëve të ndryshme, administratorët e shkollave, studentët e degëve arsimore, hartuesit e kurrikulave dhe të teksteve shkollore, zyrtarët e arsimit, si dhe të gjithë ata të cilët tregojnë interesim për përdorimin e metodologjive të avancuara në mësimdhënie dhe të nxënësve.

Forma e organizimit/ Kohëzgjatja

Programi i trajnimit “Mendimi kritik gjatë leximit dhe shkrimit” i ka 48 orë. Programi realizohet në formë të programit pesëditësh të trajnimit (30 orë), dhe zhvillimit profesional gjatë punës në realizimin e teknikave të programit (18 orë). Forma e organizimit dhe kohëzgjatja është si vijon:

- Organizimi i dy ditëve të para të trajnimit;
- Zbatimi në klasa i teknikave nga dy ditët e para;
- Organizimi i ditës së tretë dhe të katërt të trajnimit;
- Planifikimi dhe zbatimi i njësive mësimore me përdorimin e teknikave të MKLSH;
- Organizimi i ditës së pestë të trajnimit, ku pjesëmarrësit prezantojnë përvojat e tyre nga zbatimi i teknikave në klasë dhe pranojnë informata kthyesë nga kolegët dhe trajnerët.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 4 nga 4

Vlerësimi/Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 48 orë (30 orë trajnimi si dhe 18 orë zhvillimi përmes punës në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- Dokumentimi i punës praktike në klasë:
 - Dëshmi të zbatimit të teknikave të ndryshme të MKLSH-së mes ditës së dytë dhe të tretë;
 - Dëshmi të planifikimit dhe zbatimit të së paku tri njësive mësimore me përdorimin e teknikave të MKLSH.

Materialet e trajnimit

Dokumenti kryesor për programin e trajnimit është udhëzuesi për trajnerë, i cili u shërben trajnerëve për të ofruar me sukses programin. Ofrimi i programit përkrahet me fletat e punës (shtojcat) dhe me prezantimin në Power Point, sipas ditëve të trajnimit. Ndërsa, mësimdhënësit do të mund të shfrytëzojnë edhe udhëzuesit e MKLSH për zbatim në mësimdhënien e tyre, pas programit të trajnimit.